



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 122 prot.

Tiranë, më 12.01.2026

VENDIM

Nr. 01, datë 12.01.2026

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, përfaqësues i emisionit “Piranjat”, (në vijim “ankuesi”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”), formularin e ankesës nr. 3074 Prot., datë 26.11.2025 me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik/Fondi Shqiptar i Zhvillimit (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, nëpërmjet kërkesës datë 01.08.2025, depozituar në adresën elektronike adf@albaniaidf.org, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1. *Strukturën e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, emër dhe mbiemër të stafit, si dhe pozicionin e tyre në këtë strukturë.*

Autoriteti Publik, me e-mail-in datë 14.11.2025, ka kthyer përgjigje duke refuzuar dhënien e informacionit të kërkuar me pretendimin se: “*Fondi Shqiptar i Zhvillimit është person juridik me status organizate jofitimprurëse, duke gëzuar pavarësi të plotë drejtuese, administrative financiare dhe teknike, organizatë e cila ka objekt të veprimtarisë nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe social, të qëndrueshëm, të balancuar dhe koheziv, në nivel rajonal e vendor.*”

Referuar këtij statusi juridik të veçantë, nuk është entitet buxhetor i administratës shtetërore. Bazuar në legjislacionin në fuqi, punëdhënësi nuk ka detyrim ligjor të japë të dhëna personale të punëmarrësve, pa pëlqimin e tyre të shprehur ose në rastet kur parashikohet ndryshe.”.

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”, Komisioneri nëpërmjet shkresës nr. 3074/1 Prot., datë 04.12.2025, ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur, lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar, duke rivlerësuar në këtë mënyrë kërkesën për informacion, brenda datës 10.12.2025.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 4759/1 prot., datë 11.12.2025, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me shkresën nr. 3074/2 Prot., datë 15.12.2025, ka kthyer përgjigje, duke refuzuar dhënien e informacionit me pretendimin se:

“Argumentimi që ju jepni duke e konsideruar FSHZH si Autoritet Publik bazuar në shkronjën c) të pikës 1 të nenit 2 të LDI, i cili parashikon se: Autoritet Publik c) çdo person fizik ose juridik të cilit i është dhënë me ligj akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi e drejta e ushtrimit të funksioneve publike”, nuk qëndron me arsyetimin ligjor si më poshtë.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 10 130, datë 11.5.2009, "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit", i ndryshuar, konkretisht të nenit 4 të tij, ka të përcaktuar shprehimisht se:

"Statusi juridik

- 1. FSHZH-ja është person juridik dhe gëzon statusin e organizatës jofitimprurëse.*
- 2. FSHZH-ja gëzon pavarësi drejtuese, administrative, financiare dhe teknike.*
- 3. FSHZH-ja e ushtron veprimtarinë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, me statutin, manualin e procedurave, si dhe me kushtet e përcaktuara në marrëveshjet e financimit dhe 1e zbatimit të projekteve.*
- 4. FSHZH-ja është e organizuar si një subjekt juridik, me qendër në Tiranë, që ka të drejtë të krijojë struktura të tjera, në nivel vendor, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në statut."*

Rezulton se është person juridik me status organizatë jofitimprurëse dhe gëzon pavarësi drejtuese, administrative, financiare dhe teknike, ashtu siç përcaktohet shprehimisht nga ky ligj.

Dispozitat e ligjit të sipërcituar kanë përcaktuar formën e organizimit, të rregullave të funksionimit dhe të administrimit të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

FSHZH-ja ushtron veprimtarinë e saj në bazë të këtij ligji, të statutit, manualit të procedurave, si dhe marrëveshjeve të financimit dhe zbatimit të projekteve.

Statusi juridik dhe organizativ Fondit Shqiptar të Zhvillimit është i përcaktuar në mënyrë të posaçme nga ligji nr. 10 130, datë 11.5.2009, "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit", i ndryshuar, i cili vlen të theksohet se përbën një "akt lex specialis", që rregullon ekskluzivisht mënyrën e krijimit, funksionimit, strukturës dhe natyrës së aktivitetit të organizatës.

Për më tepër, duke u bazuar edhe në kompetencat e FSHZH, që janë ngarkuar nga dispozitat e ligjit organik nr. 10 130, konkretisht në nenin 6 të tij, rezulton se FSHZH ushtron veprimtari me natyrë të veçantë që lidhet me planifikimin, zbatimin dhe menaxhimin e projekteve, të kufizuar në menaxhimin, financimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e projekteve të zhvillimit rajonal dhe vendor. Këto funksione janë tërësisht teknike dhe nuk përbëjnë ushtrim të autoritetit publik në kuptimin e ligjit nr. 124/2024, i ndryshuar, pasi FSHZH nuk nxjerr akte administrative detyruese, nuk ushtron kontroll administrativ, nuk merr vendime që krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë të drejta e detyrime për publikun dhe nuk ushtron kompetenca autoritative. FSHZH nuk merr vendime detyruese për shtetasit, nuk jep licenca, nuk ushtron kontroll, nuk ushtron kompetenca tipike të një "Autoriteti Publik".

Marrëdhëniet e FSHZH-së me subjektet e tjera bazohen në instrumente kontraktuale si marrëveshje financimi, bashkëpunime etj. duke e pozicionuar këtë organizatë si një njësi implementuese të projekteve dhe jo si "organ" apo "Autoritet" që ushtron funksione publike në kuptimin të ligjit nr. 124/2024 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.

Në zbatim të parimit "ex specialis derogat legi gjeneral", dispozitat e ligjit të posaçëm kanë përparësi ndaj interpretimeve që mund të rrjedhin nga ligje të përgjithshme, siç është ligji nr. 124/2024 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, i cili vepron në mënyrë horizontale për autoritetet publike. Duke qenë se ligji i posaçëm e klasifikon FSHZH si organizatë jofitimprurëse me pavarësi drejtuese, administrative, financiare dhe teknike, pa kompetenca autoritative në ushtrimin e funksioneve publike, ai nuk mund të trajtohet si "Autoritet Publik", në kuptimin e nenit 2 të ligjit 124/2024, i ndryshuar.

Si përfundim nga sa parashtruam më sipër, vlerësojmë se FSHZH nuk është subjekt i ligjit nr. 124/2024, i ndryshuar, në raport me kërkesën që ka paraqitur subjekti emisioni "Piranjat" për vënien në dispozicion të strukturës me emrat dhe pozicionet individuale të punonjësve."

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi me e-mail-et regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 3074/3 prot., datë 22.12.2025 dhe nr. 3074/4 Prot., datë 29.12.2025, ka vijuar ankimin, duke kërkuar nga Komisioneri detyrimin e Autoriteti Publik për të vendosur në dispozicion informacionin sipas objektit të kërkesës për informacion.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, argumentet e parashtruara nga Autoriteti Publik për mos vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, nuk janë në përputhje me parashikimet e LDI.

Në lidhje me argumentin e parashtruar nga Autoriteti Publik, sipas së cilit: “...ligji i posaçëm e klasifikon FSHZH si organizatë jofitimprurëse me pavarësi drejtuese, administrative, financiare dhe teknike, pa kompetenca autoritative në ushtrimin e funksioneve publike, ai nuk mund të trajtohet si "Autoritet Publik", në kuptimin e nenit 2 të ligjit 124/2024, i ndryshuar...”, Komisioneri vlerëson se, ky argument nuk qëndron.

Bazuar në ligjin nr. 10130, datë 11.05.2009 “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, neni 2 i tij përcakton se: “Fusha e veprimtarisë së FSHZH-së është nxitja e zhvillimit ekonomik dhe social, të qëndrueshëm, të balancuar dhe koheziv, në nivel rajonal e vendor, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit”. Po ashtu në nenin 5, “Objektivat e FSHZH -së” parashikohet se: Në përmbushjen e funksioneve dhe të kompetencave të parashikuara në këtë ligj, FSHZH-ja udhëhiqet nga këta objektiva kryesorë: a) përmirësimi i infrastrukturës social-ekonomike vendore; b) përmirësimi i shërbimeve publike vendore; c) forcimi institucional i njësive të qeverisjes vendore; ç) nxitja e qeverisjes së mirë në nivel vendor.

Ndërkohë, në nenin 6 i tij përcaktohet Objektin e veprimtarisë dhe Kompetencat e FSHZH-së, sipas të cilit parashikohet se: “1. Objekti i veprimtarisë së FSHZH-së është, sipas rastit, hartimi, menaxhimi, financimi, zbatimi, mbikëqyrja e projekteve të lidhura me fushën e veprimtarisë. 2. Kompetencat kryesore të FSHZH-së janë: a) menaxhimi i projekteve të financuara nga Qeveria Shqiptare dhe/ose donatorë të ndryshëm, që kanë si qëllim zhvillimin rajonal dhe vendor. b) dhënia e mbështetjes financiare në të gjitha format, si grant, hua, garanci etj. për njësitë e pushtetit vendor, për përmirësimin e infrastrukturës social-ekonomike dhe të shërbimeve publike vendore; c) dhënia e mbështetjes teknike për zbatimin, ndjekjen dhe mbikëqyrjen e investimeve, për përmirësimin e infrastrukturës social-ekonomike dhe të shërbimeve publike vendore; ç) dhënia e asistencës teknike dhe kryerja e trajnimeve, për rritjen e kapaciteteve institucionale të pushtetit vendor; d) kryerja e veprimtarive të ndryshme, në funksion të zbatimit të politikave e të instrumenteve të zhvillimit rajonal dhe vendor.

Referuar, gjithashtu shkronjave a), b) dhe c) të pikës 1 të nenit 8 të ligjit të sipërcituar, përcaktohet se: “Të ardhurat në buxhetin e FSHZH-së krijohen nga: a) fondet e përfituara nga marrëveshjet ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe donatorëve të ndryshëm, për financimin e projekteve, të zbatuara nga FSHZH-ja; b) fondet nga Buxheti i Shtetit, nga individë dhe institucione, brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, sipas marrëveshjeve përkatëse; c) fondet nga bashkëfinancimi i përfituesve dhe i njësive të qeverisjes vendore;...”. Bazuar në ligjin nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” i ndryshuar, konkretisht të pikës 3 të nenit 2, “Organizata jofitimprurëse” kuptohet shoqatat, fondacionet dhe qendrat, veprimtaria e të cilave zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe pa u ndikuar nga shteti”, si dhe të nenit 6 të tij “Parimi i pavarësisë nga shteti” përcaktohet se “Organizatat jofitimprurëse e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë të pavarur nga organet dhe interesat shtetërore”.

Ndërkohë, LDI në pikën 1 të nenit 2, përcakton qartë se “*Autoritet publik*”: a) është çdo organ publik, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës “c” të kësaj pike; c) **çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.**

Në kuptim të parashikimeve të mësipërme, FSHZH edhe pse gëzon statusin e organizatës jofitimprurëse, pavarësi drejtuese, administrative, financiare dhe teknike, është person juridik, i cili ushtron funksione publike, si dhe në zbatim të ligjit nr. 10130, datë 11.05.2009 “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, harton strategji dhe menaxhon projekte, fondet e të cilave krijohen nga Buxheti i Shtetit, dhe marrëveshjet e lidhura nga Shteti Shqiptar për përfitimin e granteve, huave, garancive dhe nuk përjashtohet si subjekt i LDI për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës dhe llogaridhënies, mbështetur në pikën 2 të nenit 1 të LDI. Analiza e mësipërme, vjen në përputhje të plotë gjithashtu me përcaktimet e pikës “ç” të nenit 11, të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky qëndrim është konsoliduar nëpërmjet vendimeve të Komisionerit, vendimit nr. 41, datë 5.10.2020 dhe të vendimit nr. 24, datë 16.4.2021, vendim ky i cili është lënë në fuqi dhe nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë me nr. 2578, datë 27.09.2021.

Gjithashtu, në kundërshtim të pretendimeve të mësipërme, statusi i FSHZH-së, si subjekt i LDI është pranuar dhe nga vet Autoriteti Publik, i cili në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në nenet 6, 7, 8 dhe 10 të këtij ligji, ka publikuar në faqën zyrtare të tij Programin e Transparencës, https://www.albaniandf.org/prog_transp/.

Ndërkohë, përsa i përket informacionit të kërkuar, mbi emrat e punonjësve të FSHZH, gjen mbrojtje nga ligji nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, pasi në nenin 44, pika 2 të tij parashikohet shprehimisht se: “2. Aksesi i publikut në informacionin publik, siç përcaktohet në ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, dhe aksesi i publikut në informacionin që lidhet me kryerjen e funksioneve dhe të detyrave zyrtare, nuk pengohet nga e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale të personave fizikë, të cilët konsiderohen si autoritete publike ose ushtrojnë funksione shtetërore, përveç rasteve kur të drejta të tjera themelore, si e drejta e tyre për jetën ose e drejta e tyre për integritet fizik e mendor kërkojnë mbrojtjen e të dhënave të tyre në një rast ose kategori të caktuar rastesh.”

Në këto rrethana, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se informacioni/dokumentacioni i kërkuar, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2 të LDI, sipas të cilit “*Informacion publik*” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo

administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Gjithashtu, bazuar në nenin 7, pika 1, shkronja d të LDI dhe Urdhrit nr. 280 datë 30.12.2025 “Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Autoritetet Publike”, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, një pjesë e informacionit të kërkuar përfshihet në kategorinë e informacionit që vendoset në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Konkretisht, dispozita e sipërcituar përcakton se: *“Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime”.*

Nga sa më sipër, Autoriteti Publik jo vetëm duhet të kishte trajtuar kërkesën për informacion, por në zbatim të nenit 7 të LDI, duhet që informacionin e kërkuar ta bëj publik në mënyrë proaktive në programin institucional të transparencës.

Zyra e Komisionerit thekson se, LDI, ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

Në këtë kontekst, sjellim në vëmendjen tuaj se, Zyra e Komisionerit ka krijuar një praktikë të konsoliduar përmes vendimmarrjeve për raste të ngjashme të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare, konkretisht në linkun <https://www.idp.al/vendime-ddi/>, si vendimet nr. 32, datë 10.07.2018; nr. 21, datë 09.04.2021; nr. 23, datë 13.04.2021; nr. 50, datë 17.11.2021; nr.19, datë 15.05.2023, etj.

Bazuar në pikën 3, të nenit 3 e LDI parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.*

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për

organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së z. _____, përfaqësues i Emisionit “Piranjat”, me nr. 3074 Prot., datë 26.11.2025, ndaj Autoritetit Publik, Fondi Shqiptar i Zhvillimit me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit, konkretisht: *“Strukturën e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, emër dhe mbiemër të stafit, si dhe pozicionin e tyre në këtë strukturë”*, brenda datës 19.01.2026.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 12.01.2026

KOMISIONERI

Besnik Dervishi